

SUMI-ALPHA 5 EC

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



Rrezik

I dëmshëm nëse gëlltitet

Irritues për sytë

I rrezikshëm për peshqit

Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit

SUMIALFA 5 EC është insekticid i grupit të piretroideve sintetike me një spekter të gjere veprimi.

Lënda vepruese: *Esfenvalerate 5%*

Formulimi: *koncentrat i emulsueshem (EC)*

Deklaratat e rrezikut:

H226-Lëng dhe avull të ndezshëm.

H302+H332-E dëmshme po të gëlltitet ose po të frymëthithet.

H304-Mund të jetë vdekjeprurëse po të gëlltitet dhe të depërtojë në rrugët e frymëmarrjes.

H317-Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës.

H318-Shkakton dëmtime serioze të syve.

H335-Mund të shkaktojë irritim të rrugëve të frymëmarrjes.

H371-Mund të shkaktojë dëmtime të organeve.

H373-Mund të shkaktojë dëmtime të organeve në rast ekspozimi të zgjatur ose të përsëritur.

H410-Shumë toksike për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

Deklarata parandaluese:

P280-Përdorni doreza mbrojtëse, rroba mbrojtëse dhe mbrojtje për sytë ose mbrojtje për fytyrën.

P210-Mbajeni larg nxehtësisë, sipërfaqeve të nxehta, shkëndijave, flakëve të gjalla dhe burimeve të tjera flakëmarrëse. Ndalohet duhani.

P273-Shmangni çlirimin në mjedis.

P260-Mos frymëthithni avujt ose spërkat.

P391-Grumbullojini derdhjet.

P301+P310+P330+P331-PO TË GËLLTITET: Merrni menjëherë në telefon një QENDËR HELMIMI ose një mjek. Shpëlajeni gojën. MOS provokoni të vjellë.

P305+P351+P338+P310-PO TË BJERË NË KONTAKT ME SYTË: Shpëlani me ujë me shumë kujdes, për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse keni të tilla dhe nëse mund ta bëni këtë pa vështirësi. Vazhdoni të shpëlani. Merrni menjëherë në telefon një QENDËR HELMIMI ose një mjek.

P403+P233-Ruani në një vend të ajrosur mirë. Mbajeni enën të mbyllur mirë.

P403+P235-Mbajeni të freskët.

P501-Hidheni përmbajtjen/kontejnerin në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Ingredientë të rrezikshëm: ksilen, etilbenzen, esfenvalerate (ISO), 2-fenoksietanol.

EUH401-Për të shmangur rreziqet ndaj shëndetit të njeriut dhe mjedisit, ndiqni udhëzimet e përdorimit.

UDHEZIME PËR NDIHMEN E PARE DHE KESHILLA PËR MJEKUN:

Kontakt me sytë: Kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë. Telefonojini një qendër helmimesh ose mjekut. Menjëherë shpëlajini sytë me ujë të bollshëm, duke ngritur me gisht herë pas here qepallat e sipërme dhe të poshtme. Kontrolloni për lente kontakti dhe hiqini nga sytë sipas rastit. Vazhdoni të shpëlani për të paktën 10 minuta. Djegiet kimike duhen trajtuar menjëherë nga mjeku.

Frymëthithje: Kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë. Telefonojini një qendër helmimesh ose mjekut. Nxirreni viktimën në ajër të pastër dhe mbajeni të qetë në një pozicion ku mund të marrë frymë lirisht. Nëse dyshohet se ka ende tymra, forcat e shpëtimit duhet të përdorin maska të përshtatshme ose aparat frymëmarrjeje autonom. Nëse viktimë nuk po merr frymë, nëse frymëmarrja është e parregullt ose nëse ka ndodhur pushim i frymëmarrjes, i duhet dhënë frymëmarrje artificiale ose oksigjen nga personel i trajnuar. Mund të jetë e rrezikshme për ofruesin e ndihmës të japë frymëmarrje gojë-më-gojë. Nëse personi është pa ndjenja, vendoseni në pozicion sigurie të kthyer në krah me gjunjë të ngritur drejt krahërorit, dhe kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore. Mbajini të hapura rrugët e frymëmarrjes. Lironi veshjet e ngushta, si kravatën, shallin, rripin e mesit ose ndonjë rrip tjetër. Në rast frymëthithjeje të produkteve të shpërbërjes gjatë një zjarri, simptomat mund të shfaqen me vonesë. Personi i ekspozuar mund të duhet mbajtur nën vëzhgim mjekësor për 48 orë.

Kontakti me lëkurën: Kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë. Telefonojini një qendër helmimesh ose mjekut. Lajeni me sapun dhe ujë të bollshëm. Hiqni rrobat dhe këpucët e ndotura. Lajini mirë me ujë rrobat e ndotura para se t'i hiqni, ose përdorni doreza. Vazhdoni të shpëlani për të paktën 10 minuta. Djegiet kimike duhen trajtuar menjëherë nga mjeku. Në rast ankesash ose simptomash, mos lejoni ekspozim të mëtejshëm. Lajini rrobat para se t'i ripërdorni. Pastrojini mirë këpucët para se t'i përdorni përsëri.

Gëlltitje: Kërkoni ndihmë mjekësore menjëherë. Telefonojini një qendër helmimesh ose mjekut. Shpëlajeni gojën me ujë. Hiqni dhëmbët e rremë, nëse ka. Në qoftë se materiali është gëlltitur dhe personi i ekspozuar nuk i ka humbur ndjenjat, jepini të pijë sasi të vogla uji. Mos vazhdoni më nëse personi i përziehet, sepse të vjellët mund të jetë i rrezikshëm. Rrezik për frymëmarrje në rast se gëlltitet. Mund të hyjë në mushkëri dhe të shkaktojë dëmtime. Mos provokoni të vjellët. Po të shfaqen të vjella, koka duhet mbajtur poshtë, për të mos lejuar që materiali i vjellë të futet në mushkëri. Djegiet kimike duhen trajtuar menjëherë nga mjeku. Kurrë mos i jepni ndonjë gjë nga goja një personi pa ndjenja. Nëse personi është pa ndjenja, vendoseni në pozicion sigurie të kthyer në krah me gjunjë të ngritur drejt krahërorit, dhe kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore. Mbajini të hapura rrugët e frymëmarrjes. Lironi veshjet e ngushta, si kravatën, shallin, rripin e mesit ose ndonjë rrip tjetër.

Shënime për mjekun: Në rast frymëthithjeje të produkteve të shpërbërjes gjatë një zjarri, simptomat mund të shfaqen me vonesë. Personi i ekspozuar mund të duhet mbajtur nën vëzhgim mjekësor për 48 orë. Trajtime specifike: Nuk ka trajtim specifik.

Perdorimi:

Perdoret ne bimët e arave, bimët industriale, perime, vreshte dhe peme frutore kunder:

Rendi i Lepidoptereve: krimbat e misrit, krimbi i murrme, krimbi i bocës së pambukut, krimbi i kuq i pambukut, krimbi i molles, tenja e molles, krimbi i lakres.

Rendi i Hemiptereve: cimka e grurit, cimka e pambukut, cimka e jonxhes.

Rendi i Homoptereve: breshkezat, krahebardha dhe afidet.

Rendi i Ortoptereve: karkalecat.

Rendi i Koleoptereve: shushunjat e drithrave, bubureci i patates, etj.

Kunder breshkezes së Kalifornisë perdoret vetëm kur ka infeksion në fruta.

Në të gjitha rastet perdoret në përqendrimin 0.02-0.05%

Kujdes: Mos u fut në vendin e trajtuar pa veshje mbrojtëse dhe pa u tharë tretësira e sperkatjes.

Fitotoksiciteti:

Kur perdoret në dozë dhe koncentrimet e rekomanduara nuk jep shenja fitotoksiciteti.

Verejtje për përdorimin:

Masat për përdorim të sigurtë:

Vishni pajisje të përshtatshme për mbrojtje personale.

Personat që dihet se kanë probleme mbindjeshmërie të lëkurës nuk duhet të marrin pjesë në asnjë proces pune ku përdoret ky produkt.

Mos e lejoni të bjerë në kontakt me sytë, lëkurën ose rrobat.

Mos e thithni në mushkëri avullin ose aerosolin.

Mos e gëlltitni. Shmangni çlirimin në mjedis.

Përdoren vetëm nëse ka ajrim të mjaftueshëm.

Përdorni një aparat respirator të përshtatshëm, kur ajrosja është e pamjaftueshme.

Mos u futni në zona të magazinimit dhe në mjedise të mbyllura, nëse nuk janë të ajruara mirë.

Mbajeni në enën origjinale ose në enë rezervë të miratuar, prej materiali të pajtueshëm, të mbajtur mbyllur mirë kur nuk është në përdorim.

Enët e zbrazët mund të kenë ruajtur mbeturina të produktit dhe të përbëjnë rrezik.

Mos e ripërdorni enën.

Ndikimi ne mjedis:

Helmues për bletët dhe zogjtë. Shumë helmues për peshqit dhe organizmat ujore. SP1: Mos e ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Mos i pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor. Shmangni ndotjen nëpërmjet sistemeve të kullimit nga fermat ose rrugët.

Karenca:

Per te gjithë kulturat 21 dite.

Magazinimi:

Ruajeni sipas rregulloreve vendore. Ruajeni në një zonë të veçuar dhe të miratuar. Ruajeni në enën origjinale të mbrojtur nga drita e drejtpërdrejtë e diellit, në një zonë të freskët dhe të ajruar mirë, larg nga materiale të papajtueshme, si dhe nga ushqimet dhe pijet. Ruajeni të mbyllur me çelës. Eliminoni të gjitha burimet ndezëse.

Nr dhe data e regjistrimit: 29/2; date 14.11.2011;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 250 dhe 500 ml.

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese:

Tipi i ambalazhit baze: shishe plastike PET (polyethylene terephthalate).

Emri dhe adresa e Aplikantit: Sumitomo Chemical Co. Ltd. Adresa: Osaka, Japoni.

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Sumitomo Chemical Co. Ltd. Adresa: Osaka, Japoni.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise):